

## PROCESVERBAL

### I

#### I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË GJYKATËS SË LARTË

Tiranë, më 27.01.2026

Me datë 27.01.2026, me kërkesën dhe nën drejtimin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijon:

*1. Intervista me kandidatët e kualifikuar për vendet vakante:*

- Përgjegjës i sektorit të regjistrimit, Drejtorja e Administratimit Gjyqësor;*
- Sekretar gjyqësor, Sektori i Regjistrimit;*
- Specialist, Sektori i marrëdhënieve me Publikun;*
- Specialist, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë;*
- Specialist, Qendra e Dokumentacionit.*

*2. Dhënia e statusit të nëpunësit civil gjyqësor për 2 (dy) specialistë.*

*3. Të ndryshme.*

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

1. Sokol SADUSHI – Kryetar i Gjykatës së Lartë
1. Ilir PANDA – Anëtar Gjykatës së Lartë
2. Kelment GRECA – Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Të pranishëm në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

- 1) A. V. - Drejtore e Kabinetit të Kryetarit
- 2) M.K. – Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit
- 2) A. K. – Kancelare në detyrë

- 3) I. V. – Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë
- 4) V. T. – Sekretare gjyqësore
- 6) V. XH. – Specialiste IT në Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë.

Në fjalën hyrëse, Kryetari i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës, i cili pasi u miratua, vijoi me diskutimin e pikave të rendit të ditës.

Lidhur me **pikë e parë** të rendit të ditës, e cila kishte të bënte me intervistimin e kandidatëve të kualifikuar në fazën finale të konkurimit për vendet vakante

- *Përgjegjës i sektorit të regjistrimit, Drejtoria e Administratimit Gjyqësor;*
- *Sekretar gjyqësor, Sektori i Regjistrimit;*
- *Specialist, Sektori i marrëdhënieve me Publikun;*
- *Specialist, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë;*
- *Specialist, Qendra e Dokumentacionit.*

anëtarët e Këshillit vijuan me intervistën e kandidatëve të kualifikuar për pozicionet vakante respektive.

Në përfundim të procesit të intervistimit të kandidatëve, Këshilli përzgjodhi si vijon:

- për pozicionin “*Përgjegjës i sektorit të regjistrimit, Drejtoria e Administratimit Gjyqësor*” kandidatin E.P.
- për pozicionin “*Sekretar gjyqësor, Sektori i Regjistrimit*”, kandidatin K. L.
- për pozicionin “*Specialist, Sektori i marrëdhënieve me Publikun*”, kandidatin N. R.
- për pozicionin “*Specialist, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë*”, kandidatin M. M.
- për pozicionin “*Specialist, Qendra e Dokumentacionit*”, kandidatin A. H.

Lidhur me **pikën e dytë** të rendit të ditës, që kishte të bënte me konfirmimin e statusit të nëpunësit civil gjyqësor të z. D. A. në Qendrën e Dokumentacionit dhe z. G. H. në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë, të cilët kanë qenë në periudhë prove, Këshilli i Gjykatës pasi dëgjoi raportin e kancelares në detyrë Zj. A. K. si dhe shqyrtoi vlerësimet e përgatitura për këta nëpunës në provë, vendosi konfirmimin si nëpunës civilë gjyqësorë të z. D. A. dhe z. G. H.,